

Sumitomo Electric Group

KODI I SJELLJES SË FURNITORIT

Përmbajtja

<p>Angazhimi për Pajtueshmëri me Ligjin</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Ne Presim Pajtueshmëri me Ligjet Anti-Korrupsion -Ne Presim Pajtueshmëri me Ligjet e Konkurrencës -Ne Presim Mbrojtjen e Pronës Intelektuale të SEG -Ne Presim Pajtueshmëri me Ligjet Ndërkombëtare të Tregtisë
<p>Angazhimi për Burime të Përgjegjshme</p>	<ul style="list-style-type: none"> -Angazhimi me Zinxhirin e Furnizimit -Mineralet nga konfliktet -Praktikat e Përgjegjshme dhe të Qëndrueshme të Burimeve
<p>Angazhimi ndaj Njerëzve</p>	<ul style="list-style-type: none"> -Ne Presim Pajtueshmëri me Ligjet e Punësimit -Ne e Kundërshtojmë Përdorimin e Punës së Detyruar -Ne Jemi Kundër Përdorimit të Punës së Fëmijëve -Ne Kundërshtojmë çdo Formë të Trafikimit të Njeriut -Ne i Kundërshtojmë Ngacmimet -Ne e Kundërshtojmë Diskriminimin dhe Nxisim Diversitetin -Ne i Respektojmë të Drejtat e Organizimit të Punëtorëve -Ne Jemi të Përkushtuar për Mjedise të Sigurta të Punës -Ne Presim që Të Dhënat Personale të Mbrohen
<p>Angazhimi ndaj Shoqërisë</p>	<ul style="list-style-type: none"> -Ne Jemi të Përkushtuar që të Mbrojmë Mjedisin - Ne Jemi të Përkushtuar që të Ndihmojmë të Përparojnë Komunitetet Ku Veprojmë
<p>Angazhimi për Pajtueshmëri dhe Etikën e Biznesit</p>	<ul style="list-style-type: none"> -Ne Presim që Furnitorët t'u Sigurojnë Punonjësve një Mundësi për të Raportuar Shqetësimet -Ne Presim që Furnitorët të Mbajnë Informacion të Saktë të Biznesit -Ne Presim që Furnitorët të Miratojnë Iniciativa të Përshtatshme për Pajtueshmëri dhe Etikë
<p>Çështjet që Lidhen me këtë Kod</p>	

Fryma Sumitomo

Banji-nissei - Bëni më të mirën tuaj, jo vetëm në biznes por në çdo aspekt të jetës tuaj.

Shinyo-kakujitsu - Kushtojini rëndësi integritetit dhe menaxhimit të mirë.

Fusu-furi - Mos sakrifikoni kurrë; integritetin për fitime të lehta.

Sumitomo Electric Group

Kodi i Sjelljes së Furnitorit

Për më shumë se 120 vjet, Grupi Sumitomo Electric (“**SEG**”) është udhëhequr nga Fryma Sumitomo, duke vënë theksin tek integriteti dhe etika në të bërit biznesit. SEG përpiqet të kontribuojë në shoqëri përmes veprimtarive të drejta dhe të qëndrueshme të biznesit dhe duke bërë biznes me furnitorë të cilët ndajnë përkushtimin e tij për integritetin dhe etikën e biznesit.

Ky Kod i Sjelljes së Furnitorit (“**Kodi**”) përcakton pritshmëritë e SEG ndaj furnitorëve tanë, që përfshin furnitorët, nënkontraktorët, agjentët, konsulentët, distributorët ose çdo palë tjetër që merr pagesa nga SEG për produktet ose shërbimet e tij.

Në SEG ne e pranojmë që furnitorët tanë luajnë një rol të rëndësishëm në suksesin tonë të përgjithshëm. Ne i vlerësojmë kontributet që furnitorët tanë japin në biznesin tonë. Ne zgjedhim të bëjmë biznes me furnitorë që ndajnë përkushtimin tonë për integritet dhe për të bërë biznes në përputhje me ligjin. SEG kërkon që furnitorët tanë të bëjnë biznes në një mënyrë që është në përputhje me parimet e paraqitura më poshtë dhe që ata që përcjellin pritshmëri të ngjashme në të gjithë zinxhirët e tyre të furnizimit.

Angazhimi për Pajtueshmëri me Ligjin

SEG pret që furnitorët tanë t’i kryejnë aktivitetet e tyre të biznesit në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Ne Presim Pajtueshmëri me Ligjet Anti-Korrupsion

Ryshfeti shkakton dëm të madh në komunitete dhe mund të shkaktojë dëme të konsiderueshme në SEG. SEG pret që furnitorët tanë të veprojnë në përputhje me të gjitha ligjet e zbatueshme anti-korrupsion. Për më tepër, kur një furnitor ndërvepron me një zyrtar qeveritar në emër të SEG, furnitori është krejtësisht i ndaluar të ofrojë, të japë ose të marrë diçka me vlerë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, për të marrë një avantazh të papërshtatshëm të biznesit.

Ne Presim Pajtueshmëri me Ligjet e Konkurrencës

SEG është përkushtuar të zbatojë ligjet e konkurrencës dhe *antitrust*-it dhe ne presim një nivel të ngjashëm të përkushtimit nga furnizuesit tanë.

Ne Presim Mbrojtjen e Pronës Intelektuale të SEG

SEG pret që furnitorët tanë të mbrojnë çdo pronë intelektuale të SEG që është marrë gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënies sonë.

Ne Presim Pajtueshmëri me Ligjet Ndërkombëtare të Tregtisë

SEG është krenar që është një shoqëri globale dhe që ka furnitorë të vendosur në të gjithë botën. Ne presim që furnitorët tanë të respektojnë ligjet dhe rregulloret e zbatueshme të importit dhe eksportit dhe kërkesat e tjera të tregtisë ndërkombëtare.

Angazhimi për Burime të Përgjegjshme

Angazhimi me Zinxhirin e Furnizimit

Menaxhimi i qëndrueshëm i zinxhirëve të furnizimit ka një rëndësi në rritje për palët tona të interesit, përfshirë klientët dhe investitorët. Ne kemi vendosur kërkesa sociale dhe mjedisore për furnitorët tanë për shumë vite. Ne do të vazhdojmë bashkëpunimin tonë me furnitorët dhe do të rrisim angazhimet tona në fushat strategjike dhe e gjithë kjo, për të përmirësuar aftësitë e qëndrueshme në zinxhirin e furnizimit.

Mineralet nga konfliktet

Në veçanti, SEG kërkon që furnitorët tanë të ndërmarrin hapat e duhur për të përcaktuar nëse produktet e tyre përmbajnë minerale nga konfliktet (kallaj, tantal, tungsten dhe ar) dhe nëse po, të zbatojnë procese për të identifikuar burimet e këtyre mineraleve dhe të zbatojnë të gjitha ligjet dhe rregulloret që rregullojnë burimin dhe përdorimin e mineraleve konfliktuale. Ne presim që furnitorët të eliminojnë përdorimin e mineraleve nga konfliktet që - drejtpërdrejt ose tërthorazi - financojnë ose nga të cilat përfitojnë grupe të armatosura në Republikën Demokratike të Kongos ("RDK") dhe vendet fqinje.

Praktikat e Përgjegjshme dhe të Qëndrueshme të Burimeve

RDK është gjithashtu prodhuesi më i madh në botë i kobaltit. Nxjerrja e kobaltit ngre shqetësime të ngjashme me mineralet nga konfliktet dhe është bërë gjithashtu një shqetësim.

Ne i nxisim furnitorët tanë të përdorin praktika të përgjegjshme dhe të qëndrueshme për të furnizuar të gjitha lëndët e para, përfshirë kobaltin dhe mineralet e tjera. Ne i nxisim të gjithë furnitorët të marrin parasysh zhvillimet e standardeve ndërkombëtare dhe zhvillimet në lidhje me çështjet mjedisore, të drejtat e njeriut dhe probleme të tjera sociale, veçanërisht në zonat e prekura nga konflikti dhe me rrezik të lartë.

Angazhimi ndaj Njerëzve

SEG është e përkushtuar ndaj respektimit të të drejtave të njeriut. Angazhimi ynë përfshin identifikimin, parandalimin dhe zbutjen e ndikimeve të pafavorshme të aktiviteteve tona mbi të drejtat e njeriut. Ne presim që furnitorët tanë të kenë të njëjtin respekt për të drejtat e njeriut, përfshirë përkushtimin për standardet e njohura përgjithësisht ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Ne Presim Pajtueshmëri me Ligjet e Punësimit

SEG pret që furnitorët tanë të veprojnë në përputhje me të gjitha ligjet në fuqi që rregullojnë orët e punës, pagat, përfitimet dhe kushtet e tjera të përgjithshme të punësimit, duke përfshirë kontratat e punës, nëse është e zbatueshme.

Ne e Kundërshtojmë Përdorimin e Punës së Detyruar

SEG nuk do të punojë me furnitorë të cilët - në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë - përdorin punë skllavi ose çdo formë tjetër të punës së detyruar, të shtrënguar ose të pavullnetshme në fuqinë e tyre të punës. Furnitorët nuk duhet të kërkojnë kurrë nga punonjësit ose çdo anëtar i fuqisë punëtore të tyre që të dorëzojnë pasaportat e tyre, dokumentet e identifikimit të lëshuara nga qeveria ose lejet e punës, si kusht i punësimit.

Ne Jemi Kundër Përdorimit të Punës së Fëmijëve

SEG nuk do të punojë me furnitorë të cilët - në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë - përdorin punë të paligjshme të fëmijëve gjatë ushtrimit të biznesit të tyre. Për këto qëllime, "fëmijë" i referohet kujtdo nën moshën minimale ligjore për punësim ku kryhet puna, por në çdo rast SEG nuk do të punojë me furnitorë, fuqia e drejtpërdrejtë ose tërthortë e të cilëve përfshin fëmijë të cilët nuk kanë mbushur ende moshën 15 vjeç.

Ne Kundërshtojmë çdo Formë të Trafikimit të Njeriut

SEG nuk do të punojë me furnitorë të cilët merren drejtpërdrejt ose tërthorazi me trafikimin e njerëzve.

Ne i Kundërshtojmë Ngacmimet

SEG pret që furnitorët tanë ta trajtojnë fuqinë e tyre punëtore me dinjitetin dhe respektin për të cilin kanë të drejtë të gjitha qeniet njerëzore. Furnitori duhet të krijojë një mjedis pune që nuk toleron ngacmime ose sjellje të tjera abuzive ndaj punonjësve.

Ne e Kundërshtojmë Diskriminimin dhe Nxisim Diversitetin

SEG pret që furnitorët tanë të ofrojnë mundësi të barabarta punësimi për punonjësit dhe aplikantët për punësim pa diskriminim të paligjshëm bazuar në racën, etninë, origjinën kombëtare, fenë,

moshën, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, paaftësinë ose çdo karakteristikë tjetër të mbrojtur nga ligjet në fuqi.

SEG nxit furnitorët e tij të promovojnë diversitetin dhe të nxisin një kulturë gjithëpërfshirëse dhe etike brenda vendit të punës.

Ne i Respektojmë të Drejtat e Organizimit të Punëtorëve

SEG pret që furnitorët tanë të respektojnë të drejtat e punëtorëve për t'u organizuar ose jo në përputhje me ligjin në fuqi.

Ne Jemi të Përkushtuar për Mjedise të Sigurta të Punës

SEG pret që furnitorët tanë të mbrojnë shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e njerëzve të tyre, vizitorëve dhe të tjerëve që mund të preken nga aktivitetet e tyre. Furnitorët duhet të jenë në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret e zbatueshme për shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës.

Ne Presim që Të Dhënat Personale të Mbrohen

SEG pret që furnitorët tanë të respektojnë të gjitha ligjet në fuqi që kërkojnë mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve, klientëve dhe palëve të tjera. Përveç kësaj, furnitorët duhet të njoftojnë menjëherë SEG për çdo shkelje të ligjit mbi privatësinë e të dhënave nga një furnitor ose çdo palë me të cilën furnitori bën biznes që ndikon mbi SEG.

Angazhimi ndaj Shoqërisë

Ne Jemi të Përkushtuar që të Mbrojmë Mjedisin

SEG është e përkushtuar ndaj kujdesit të mjedisit dhe zvogëlimit të ndikimit mjedisor nga aktivitetet tona. Ne gjithashtu presim që furnitorët tanë të zvogëlojnë ndikimin mjedisor të operacioneve të tyre të biznesit, të menaxhojnë rreziqet e dëmtimit të mjedisit dhe të jenë në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret e zbatueshme mjedisore. SEG i nxit furnitorët e tij që t'i kushtojnë vëmendje të veçantë veçanërisht: zvogëlimit të gazrave serë, rritjes së efikasitetit të energjisë, përdorimit të burimeve të ripërtëritshme, përdorimit efikas të energjisë, ujit dhe lëndëve të para dhe miratimit të menaxhimit të burimeve të qëndrueshme dhe proceseve të reduktimit të mbetjeve.

Ne Jemi të Përkushtuar që të Ndihmojmë të Përparojnë Komunitetet Ku Veprojmë

Një nga parimet e korporatës SEG është që ne të kontribuojmë në krijimin e një shoqërie dhe ambienti më të mirë, me një vetëdije të plotë për përgjegjësinë tonë shoqërore. Ne presim një përkushtim të ngjashëm nga furnitorët tanë.

Angazhimi për Pajtueshmëri dhe Etikën e Biznesit

Ne Presim që Furnitorët t'u Sigurojnë Punonjësve një Mundësi për të Raportuar Shqetësimet

SEG pret që furnitorët e tij t'u sigurojnë punonjësve mënyrë për ngritjen e dyshimeve të shkeljeve të ligjit ose shqetësime të tjera pa frikë nga hakmarrja. Më tej ne presim që furnitorët t'i përgjigjen shqetësimeve në mënyrë të përshtatshme.

Ne Presim që Furnitorët të Mbajnë Informacion të Saktë të Biznesit

Ne presim që furnitorët të plotësojnë të gjitha dokumentet e biznesit (përfshirë dokumentet e cilësisë) me saktësi, vërtetësi dhe në kohën e duhur. Ne gjithashtu presim që furnitorët tanë të ndajnë informacione të plota, të drejta, të sakta dhe në kohë në raportet dhe dokumentet e paraqitura te autoritetet rregullatore, përfshirë çdo raport financiar periodik. Ne presim që kur është e zbatueshme, dokumentet e furnitorëve të autorizohen si duhet. Për më tepër, ne presim që çdo regjistrim i aktiviteteve financiare të furnitorëve të jetë në përputhje me ligjet në fuqi dhe praktikën e kontabilitetit. Furnitorët nuk duhet të bëjnë shënime të rreme ose mashtruese në dokumentet dhe të dhënat e tyre dhe të mos heqin kurrë informacion nga regjistrat e tyre që u kërkohet të regjistrojnë.

Ne Presim që Furnitorët të Miratojnë Iniciativa të Përshtatshme për Pajtueshmëri dhe Etikë

Për aq sa është e mundur dhe në një mënyrë që është në përpjesëtim me madhësinë dhe natyrën e biznesit të tyre, SEG pret që furnitorët të miratojnë programe efektive të pajtueshmërisë dhe etikës së tyre. SEG nxit furnitorët e tij të zbatojnë kodet e tyre të sjelljes dhe të nxisin një kulturë të pajtueshmërisë dhe etikës së biznesit në organizatat e tyre, duke përfshirë shmangien e konflikteve të interesit.

Çështjet që Lidhen me këtë Kod

Furnitorët (ose punonjësit e tyre) mund të informojnë SEG për shqetësimet në lidhje me çështjet e rregulluara nga ky Kod. Nëse ka ndonjë shqetësim sipas këtij Kodi, ne ju nxisim të flisni me kontaktin tuaj kryesor të biznesit. Nëse kjo nuk është e përshtatshme, ju lutemi kontaktoni linjën telefonike në <https://sumitomoelectric.com/compliance-hotlines>.

SEG rezervon të drejtën për të kryer një kontroll/rishikim të furnitorëve për të siguruar pajtueshmëri me këtë Kod.

Meqenëse SEG përpiqet të bëjë biznes me furnitorë të cilët ndajnë përkushtimin tonë për pajtueshmëri me ligjin dhe praktikën etike të përgjegjshme të biznesit, ne do t'i rishikojmë kushtet e marrëdhënieve tona të biznesit nëse mësojmë se një furnitor ka shkelur ligjin ose nuk vepron në përputhje me këtë Kod. Për këtë qëllim, SEG mund të kërkojë informacion në lidhje me pajtueshmërinë e furnitorëve tanë me këtë Kod.

Nëse keni pyetje në lidhje me këtë Kod, ju lutem mos ngurroni të kontaktoni scoc-queries@info.sei.co.jp.